

Ndryshimet në legjislacion

Nëntor 2016

Në këtë publikim:

- Ligji Nr. 05/L – 120 “Për Trepçën”
- Ligji Nr. 05/L-010 “Për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës”
- Ligji Nr. 05/L-11 “Për Kamatë–Vonesat në Transaksionet Tregtare”
- Ligji Nr. 05/L- 066 “Për Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës”
- Ligji Nr. 05/L – 024 “Për shërbimin mjekësor emergjent”
- Marrëveshja Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe mbi Promovimin dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve
- Rregullore për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin të Terrorizmit
- Rregullore për Raportimin e Fondeve Plotësuese Penzionale
- Rregullore MMPH Nr. 03/2016 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi
- Rregullore për Mbajtësin e Mjeteve të Pensioneve
- Rregullore Nr. 04/2016 Për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë,
- Rregullore Nr. 02/2016 Për Kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës
- Rregullore Nr. 03/2016 Për Kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e punësuarve lidhur me punën e krahut me ngarkesa

I. Ligji Nr. 05/L – 120 “Për Trepçën”

Ligji për Trepçën është publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 31 tetor 2016, dhe ka hyrë në fuqi në datën e publikimit.

Ky ligj specifikon që Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg (Fi 690/89), Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë (Fi 349/88) dhe Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç (Fi 804/89), do të transformohen në një shoqëri aksionare Trepça sh.a. Ministria e Zhvillimit Ekonomik do të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore në lidhje me regjistrimin e Trepça sh.a pranë ARBK-së.

Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e 80% të aksioneve të Trepça Sh.A, ndërsa punëtorët kanë në pronësi 20% të aksioneve të mbetura.

Qeverisja e Trepça Sh.A. bëhet nga Bordi Mbikëqyrës dhe Bordi Menaxhues.

Dispozitat e këtij ligji mbizotërojnë mbi çdo dispozitë tjetër të legjislacionit tjetër që mund të parasheh diçka ndryshe prej asaj që parashihet me këtë ligj.

Brenda 6 muajve nga data e hyrjes ne fuqi, Ministria do të miratoj akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

II. Ligji Nr. 05/L-010 “Për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës”

Ligji për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 3 nëntor 2016, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Ky ligj përcakton organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për krahasim dhe Verifikimin të Pronës (tani e tutje "Agjencia").

Ky ligj ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale si dhe krahasimin e zgjidhjen e dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.

Brenda 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Agjencisë do të nxjerr akte nënligjore për implementimin e këtij ligji.

Me hyjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen:

- Ligjin nr. 03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 5 të Ligjit Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/10 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore si dhe të komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore.
- Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/23 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore.

III. Ligji Nr. 05/L-11- "Për Kamatë-Vonesat në Transaksionet Tregtare"

Ligji për Kamatë – Vonesat në Transaksionet Tregtare është publikuar në Gazetën Zyrtare të

Republikës së Kosovës më datë 21 nëntor 2016, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i vonesave të pagesave në transaksionet tregtare, si dhe përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatë-vonesave, në rastet e furnizimit me mallra dhe shërbime në mes të shoqërive tregtare ose në mes të shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut, duke nxitur aftësinë konkurruese të shoqërive tregtare.

Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktivën 2011/7/EU të Parlamentit dhe Këshillit Evropian, të datës 16 shkurt 2011, për "Luftën Kundër Pagesave të Vonuara në Transaksionet Tregtare", Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 48, datë 23.2.2011, f. 1-10.

Ky ligj zbatohet për të gjitha pagesat e kryera, në kompensim për punët juridike tregtare.

Ky ligj nuk zbatohet për detyrimet apo pagesat për punët juridike tregtare si në vijim:

- që janë objekt i procedurës së falimentimit të hapur kundër debitorit, përfshirë edhe rastet e ristrukturimit të borxhit;
- që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët.
- kamatë-vonesa për transaksionet mes personave fizik dhe juridik me institucionet financiare të licencuara në Kosovë, që rregullohet me akt nënligjor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).

Në mungesë të dispozitave të përcaktuara me këtë Ligj, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me përjashtim të neneve 382 dhe 383.

Dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve që rregullojnë kamatë-vonesën mbeten të zbatueshme për kontratat që janë lidhur, dhe faturat që janë lëshuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

BQK do të nxjerr akte nënligjore për kamatë-vonesat së paku 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

IV. Ligji Nr. 05/L- 066 "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës"

Ligji për Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më date 21 nëntor 2016 dhe do të hyjë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Qëllimi i këtij Ligji është përcaktimi i kushteve dhe kriterëve për ushtrimin e profesionit të rregulluar që ka të bëjë me mbrojtjen e interesit publik.

Ky Ligj është në përputhje me Direktivën 2005/36/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian e datës 7 shtator 2005 mbi njohjen e kualifikimeve profesionale (teksti me relevance të EEA); dhe Direktivën 2013/55/eu e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian e datës 20 nëntor 2013, që ndryshon Direktivën 2005/36 / EC mbi njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Rregulloren (BE) Nr.1024/2012 për bashkëpunim administrativ përmes Sistemit Informativ të Tregut të Brendshëm ('Rregullorja IMI) për njohjen e kualifikimeve profesionale si dhe në trajnimin specifik që kërkohet për disa profesione të rregulluara në sektorët e shëndetësisë dhe arkitekturës.

Ky ligj zbatohet për çdo person, i cili kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar në Republikën e Kosovës.

Ky Ligj nuk zbatohet:

- për veprimtaritë e ushtruara në profesionin e rregulluar, që lidhen me kryerjen e funksioneve në autoritetet gjyqësore;
- për profesionet, të cilat sipas legjislacionit në fuqi, kanë kërkesa të veçanta të cilat nuk janë të përfshira në listën e profesioneve të rregulluara.

Profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës janë profesionet të:

- Mjekut;
- Stomatologut;
- Farmacistit;
- Infermierit;
- Mamisë;
- Fizioterapeutit;
- Veterinerit;
- Arkitektit;
- Inxhinierit të të gjitha fushave;
- Mësimdhënësit e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar;
- Edukatorit;
- Psikologut;
- Punëtorit social;
- Pedagogut;

- Ekonomistit;
- Juristit.

Profesione të rregulluara janë edhe profesione të tjera të përcaktuara si të tilla me legjislacionin në fuqi.

Personi që kërkon të ushtrojë profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit apo kualifikimet profesionale për atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të rregulluar, çdo person duhet të:

- Përfundojë studimet përkatëse apo kualifikimet profesionale;
- Përfundojë praktikën profesionale;
- Kryej provimin shtetëror;
- Regjistrohet në organin përkatës profesional.

Kriteret e përcaktuara më lartë do të definojnë përmes akteve nënligjore që do të nxirren nga Ministria e Arsimit.

Brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Ministria e Arsimit do të nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Në rast të konfliktit mes dispozitave të këtij ligji dhe çfarëdo ligji të posaçëm përkitazi me provimin shtetëror dhe licencimin e profesionistëve, dispozitat e ligjit të posaçëm do të mbizotërojnë.



V. Ligji Nr. 05/L – 024 “Për Shërbimin Mjekësor Emergjent”

Ligji për Për shërbimin mjekësor emergjent është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më date 21 nëntor 2016 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Me këtë ligj përcaktohet mënyra e organizimit, funksionimit dhe e financimit të shërbimit mjekësor emergjent paraspitalor dhe spitalor në Republikën e Kosovës.

Shërbimi mjekësor emergjent organizohet si fushë e veçantë e veprimtarisë shëndetësore me qëllim të ofrimit të kujdesit mjekësor emergjent të pandërprerë për qytetarët të cilëve për shkak të sëmundjes apo lëndimit u është rrezikuar drejtpërsëdrejti jeta, organi i caktuar apo pjesët e caktuara të trupit, respektivisht shkurtimit të kohës optimale nga ndodhja e rastit emergjent deri në fillimin e procesit të trajtimit përfundimtar.

Shërbimi mjekësor emergjent zbatohet në nivelin paraspitalor dhe spitalor. Shërbimi mjekësor emergjent ofrohet në sektorin publik, privat dhe publiko-privat të shërbimeve shëndetësore.

Shërbimi mjekësor emergjent është pjesë përbërëse e sistemit të kujdesit shëndetësor, i cili ofrohet pa ndërprerë njëzet e katër (24) ore në ditë, shtatë (7) ditë në javë dhe organizohet si në vijim:

- Shërbimin mjekësor emergjent paraspitalor;
- Shërbimin mjekësor emergjent spitalor sekondar dhe terciar;

Veprimtarinë e shërbimit mjekësor emergjent e kryejnë:

- Mjeku specialist i emergjencës, mjeku familjar dhe mjeku i përgjithshëm.
- Paramediku – teknik mjekësor emergjent dhe,
- Infermieri.

Shërbimi mjekësor emergjent paraspitalor financohet nga:

- Buxheti i Republikës së Kosovës;
- Kontributet vullnetare;
- Donacionet;

Shërbimi mjekësor emergjent spitalor financohet nga:

- Buxheti i Republikës së Kosovës;
- Fondi i Sigurimeve shëndetësore;
- Kontributet vullnetare;
- Donacionet;

Inspektoriati i Shëndetësisë do të mbikqyrë zbatimin e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të tij.

Për shkeljen e dispozitave të këtij ligji Instuticioni i shërbimit mjekësor emergjent do të ndëshkohet me shumën duke filluar nga 1,000 Euro deri në 5,000 Euro.

Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Ministri i Shëndetësisë do ta emëroj Këshillin Profesional për shërbime mjekësore emergjente.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Kujdesin Shëndetësor Emergjent Nr. 02/L-50, i vitit 2006.

Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj vlejn aktet nënligjore të cilat nuk janë në kundërshtim me këtë ligj.

Brenda një (1) viti, nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, Ministria e shëndetësisë i nxjerrë të gjitha aktet nënligjore, që parashihen me këtë ligj.

VI. Marrëveshje Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe mbi Promovimin dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve

Marrëveshje Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe mbi Promovimin dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve është dekretuar përmes Dekretit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare Nr. I Dekretit: DMN – 022 – 2016 e cila është nënshkruar nga Presidenti I Republikës së Kosovës më 31 Tetor, 2016.

Përmes kësaj Marrëveshje, dy palët kontraktuese ndërmarrin obligimin që të promovojnë dhe inkurajojnë investimet e pales tjetër kontraktuese në territorin e tyre dhe pranojnë investimin e lartpërmendur në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm.

Investimeve nga investitorët e palës tjetër kontraktuese do ti jepet trajtim i drejtë dhe i barabartë gjatë çdo kohe dhe asnjëra palë kontraktuese nuk do të dëmtoj me masa të paarsyeshme, arbitrare apo diskriminuese menaxhimin, mirëmbajtjen, përdorimin, bashkimin apo gatishmërinë e investimeve në territorin e saj nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese.

Përmes kësaj marrëveshje palët kontraktuese ndërmarrin obligimin që t’i japin investitorëve të palës tjetër kontraktuese trajtim jo më pak të favorshëm se sa trajtimi i dhënë investitorëve të saj dhe investimeve të tyre apo të investitorëve të ndonjë Shteti të tretë dhe investimeve të

tyre lidhur me menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen, përdorimin, bashkimin, shitjen dhe likuidimin e një investimi. Megjithatë, dispozitat e lartpërmendura nuk krijojnë obligime ndaj palës kontraktuese që të rrisin përfitimet nga ndonjë trajtim, preferencë apo privilegj i investitorëve të palës tjetër kontraktuese nëse ky përfitim rrjedhë nga, përfshirë por jo kufizuar në, (i) ndonjë anëtarësim të tanishëm apo në të ardhmen në një zone të lire të tregut, në një bashkim doganor etj., (ii) çfarëdo marrëveshje ndërkombëtare apo legjislacion të brendshëm në lidhje me tatimet.

Kjo Marrëveshje specifikon që investimet e investitorëve të secilës palë kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese nuk do të shpronësohen përveç për qëllim publik, mbi baza jo-diskriminuese, në përputhje me procesin e duhur ligjor dhe me kompensimin adekuat.

Transferi i lirë nga investitorët e një pale kontraktuese brenda dhe jashtë territorit të palës tjetër kontraktuese është i lejuar në lidhje me transferin e fondeve që lidhen, por nuk kufizohen në, me investimet e tyre. Kjo Marrëveshje gjithashtu ka specifikuar rastet kur transferi i lartpërmendur mund të pengohet përkohësisht.

Zgjidhja e konflikteve në mes të një pale kontraktuese dhe një investitori të palës tjetër kontraktuese do të bëhet përmes ndërmjetësimit apo arbitrazhit nëse një konflikt i tillë nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim në mes të palëve.

Deri në një masë, e njëjta vlen edhe për konfliktet në mes të palëve kontraktuese në këtë marrëveshje. Në konfliktet në mes të palëve kontraktuese, zgjidhje në mënyrë miqësore përmes negociatave nëpërmjet kanaleve diplomatike duhet të konsiderohet deri në masën më të plotë.

Kjo Marrëveshje do të vlenë për të gjitha investimet e investitorëve të një pale kontraktuese në territorin e palës tjetër kontraktuese në përputhje me ligjet dhe rregulloret që kanë ekzistuar apo janë draftuar pas 20 Qershorit 1999 por nuk zbatohen për kontestet e investimit që kanë mundur të rezultojnë pas hyrjes së saj në fuqi.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë pas ditës së pranimit të notes së fundit diplomatike që konfirmon që palët kontraktuese do t'i përmbushin kushtet e parapara me

legjislacionin kombëtar për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje.

Kjo Marrëveshje do të jetë në fuqi për dhjetë vite dhe mund të zgjatet për një periudhë të pacaktuar kohore apo mund të shpallet e pavlefshme me shkrim përmes kanaleve diplomatike nga cilado palë kontraktuese duke dhënë njoftim prej 12 muajve.

VII. Rregullore për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit

Bordi i Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës (BQK) me datën 24 nëntor 2016 ka miratuar Rregullorën për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit. Rregullorja hynë në fuqi 30 ditë pas miratimit nga ana e Bordit të BQK-së, dhe shfuqizon Rregullin X të Plotësuar (dhe Letrën Këshilluese 2007/1) për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë Rregullore të re.

Rregullorja përcakton kriteret dhe procedurat e nevojshme për menaxhimin e procesit të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në pajtueshmëri me Ligjin nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit. Rregullorja zbatohet për të gjitha bankat, degët e bankave të huaja, institucionet mikrofinanciare, kompanitë e sigurimeve dhe institucionet financiare jobankare (më tutje të referura si institucione financiare).

Sipas Rregullorës, Bordi i Drejtorëve i institucioneve financiare, në kuadër të programit PPP/LFT duhet të:

- Miratojnë politika efektive për PPP/LFT;
- Të sigurojnë që politikat dhe procedurat ër PPP/LFT janë zbatuar plotësisht në praktikë;
- emërojnë dhe shkarkoj Udhëheqësin e Funkcionit të PPP/LFT i cili do të marrë përsipër përgjegjësitë e "zyrtarit të pajtueshmërisë" sipas nenit 21 të Ligjit për PPP/LFT. Në rastin e degëve të institucioneve financiare të huaja, emërimi apo shkarkimi i udhëheqësit të funksionit të PPP/LFT do të bëhet nga bordi i drejtorëve të institucionit financiar i cili operon përmes degës në Kosovë, në konsultim me menaxhmentin e lartë të degës në Kosovë.

- sigurojë që Funkzioni i brendshëm për PPP/LFT është pajisur teknikisht dhe me personel të cilët kanë njohuri të plotë të politikave dhe procedurave për PPP/LFT, si dhe të posedojnë standarde të larta etike dhe ekspertizë relevante;
- miratojë një politikë për krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të biznesit, veçanërisht ato që përfshijnë rrezik më të lartë, përfshirë personat e ekspozuar politikisht dhe për këtë qëllim të zhvillojnë procedura efektive të ndjeshmërisë së rrezikut për pranimin dhe largimin e klientëve, produkteve dhe shërbimeve;
- përcaktoj politikat e rrezikut lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, përfshirë pranimin dhe menaxhimin e rrezikut;
- miratoj politikën për pranim të klientëve në kuadër të menaxhimit të rrezikut të institucionit;
- marr vendime për çështjet e referuara në fushën e përgjegjësisë së tyre operacionale në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
- pranojë dhe diskutojë raportet e auditimit të brendshëm në lidhje me zbatimin e politikave dhe procedurave të PPP/LFT;
- të miratojë masa të tjera të tilla që mund të kërkohen kohë pas kohe, nga institucionet relevante.

Rregullorja përcakton obligime për Menaxhmentin e Institucionit Financiar për të miratimin e procedurave për zbatimin e politikave PPP/LFT, sigurimin e pajtueshmërisë me procedurat PPP/LFT në ato fusha të institucionit për të cilat janë përgjegjës, sigurimin e zbatimit efektiv të të gjitha politikave dhe procedurave PPP/LFT në baza ditore, dhe ofrimin në kohë të duhur Udhëheqësitë të Funkzionit të PPP/LFT, asistencën e duhur, informatat dhe këshillat për raportet e brendshme të aktiviteteve të dyshimta. Rregullorja po ashtu parasheh obligim për institucionin financiar që të trajtojë punonjësit në lidhje me kërkesat që dalin nga ligji dhe rregullorja PPP/LFT.

Rregullorja qartëson pozicionin e institucioneve financiare të cilat nuk kanë bord të drejtorëve që obligimet sipas kësaj Rregullore të përmbushen nga Menaxhmenti.

Institucionet financiare obligohet të emërojnë një Udhëheqës të pajtueshmërisë si person përgjegjës i pajtueshmërisë në pajtim me Nenin 21 të Ligjit PPP/LFT dhe paragrafët 2 dhe 3 të

këtij neni, dhe përcakton kufizime për të qenë Udhëheqës i Funkzionit të Brendshëm për LPP/LFT. Për Bankat, Udhëheqësi i Funkzionit të brendshëm PPP/LFT do të konsiderohet menaxher i lartë në pajtim me Ligjin për Bankat, ndërsa për këmbimore këtë funksion mund ta ushtrojë Drejtori i Këmbimorës.

Neni 5 i Rregullorës përcakton kërkesat minimale për politikat dhe procedurat e brendshme të PPP/LFT, ndërsa Neni 6 i Rregullorës përcakton obligim për institucionet financiare që të hartojnë dhe mirëmbajnë një program PPP/LFT me qasje të bazuar në rrezik.

Në përputhje me dispozitat e nenit 18 të Ligjit për PPP/LFT institucionet financiare duhet të përgatitin një analizë të rrezikut i cili duhet të marrë në konsideratë elementet e mëposhtme të rrezikut që janë:

- a) Rreziku i klientit (rreziku që vjen nga lloji i klientit);
- b) Rreziku i produktit (rreziku që është formuar nga qëllimi i vetë produktit);
- c) Rreziku i vendit (rreziku i formuar nga maturia gjeografike e aktiviteteve ekonomike të marrëdhënieve të biznesit).

Rregullorja e re përmban dispozita në lidhje me kujdesin e duhur ndaj klientit, identifikimin, verifikimin dhe pranimin e klientëve të ri, dhe përcaktimin e mbajtësve të të drejtës së pronësisë (pronarëve përfitues).

Rregullorja po ashtu përcakton obligimin e monitorimit të marrëdhënieve biznesore dhe transaksioneve, mbajtjen e informacioneve të plota në lidhje me transferet elektronike, ngritjen e masave të detyrueshme krahas masave standarde për të zgjeruar kujdesin e duhur në marrëdhëniet korrespondente bankare që përfaqësojnë një rrezik më të lartë për bankat, dhe zbatimin e masave të arsyeshme për të përcaktuar nëse klientët e tyre janë persona të ekspozuar politikisht. Në lidhje me të fundit, kur një person identifikohet si person i ekspozuar politikisht vendas ose i huaj me rastin e krijimit të marrëdhënieve afariste, bankat dhe institucionet të tjera financiare do të ndërmarrin masat e përcaktura në paragrafin 5.1 të nenit 22 të Ligjit për PPP/LFT.

VIII. Rregullore për Raportimin e Fondeve Plotësuese Pensionale

Bordi i Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës (BQK) me 24 nëntor 2016 ka miratuar

Rregullorën për Raportimin e Fondeve Plotësuese Pensionale. Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit të saj nga Bordi i BQK-së dhe shfuqizon Rregullin 23 mbi Raportet dhe Informatat Tjera të Kërkuara nga Fondi i Pensionit dhe Siguruesi i Pensionit të dates 23 tetor 2002.

Rregullorja përcakton afatat dhe rregullat e raportimit të Fondeve Plotësuese Pensionale në BQK dhe aplikohet për Fondet Plotësuese Pensionale.

Rregullorja përcakton si obligim për çdo Fond Plotësues Pensional dorëzimin në BQK të raporteve të cilat kanë të bëjnë me gjendjen e saj financiare, administrimin dhe operacionet, në bazë të konsoliduar, apo sipas kërkesës së BQK-së në bazë individuale. Fondi duhet t'i konsolidojë të dhënat e të gjitha aktiviteteve në një raport të vetëm.

Fondi Plotësues Pensional duhet të raportojë në Divizionin e Mbikëqyrjes Pensionale dhe Tregut të Letrave me Vlerë në BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas fundit të çdo muaji, raportet mujore si në vijim:

- Bilanci i gjendjes (F1);
- Depozitat dhe plasmanët (F5);
- Inventari i investimeve (F6);
- Blerja dhe shitja e instrumenteve financiare (F9);
- Mjetet neto dhe aksionet e kthyeshme (F14);
- Statistika - Bilanci i gjendjes (F19);
- Një listë e të gjitha mjeteve pensionale në ditën e fundit të muajit sipas administrimit dhe përkatësisë së Fondit.
- Shënime plotësuese dhe material sqarues, për ndryshimet e përgjithshme rritje/ zvogëlim për mjetet e investuara në tregun global sipas aset menaxherëve si dhe institucionet financiare që operojnë në Kosovë, krahasuar me muajin paraprak.

Jo më vonë se 20 ditë pas fundit të çdo tremujori, Fondet Plotësuese Pensionale duhet të raportojnë në Divizionin e Mbikëqyrjes Pensionale dhe Tregut të Letrave me Vlerë në BQK raportet në vijim:

- Pasqyra e të ardhurave (F2);
- Pasqyra e ndryshimeve në mjetet pensionale neto (F3);
- Derivatet e instrumenteve financiare (F8);
- Të ardhurat nga instrumentet financiare (F10);

- Llogaritë e pagueshme dhe të arkëtueshme (F11);
- Shpenzimet e investimit (F12);
- Shpenzimet operative (F13).

Pasqyrat e rrjedhës së parasë (F4) duhet të raportohen jo më vonë se 20 ditë pas fundit të çdo gjashtëmujori, dhe jo më vonë se 20 ditë kalendarike pas fundit të çdo viti kalendarik duhet të raportojnë edhe Tipologjinë e pjesëmarrësve (F15) dhe Hendekun e likuiditetit (F16).

Raportet nga Fondi Plotësues Pensional sipas kësaj Rregullore duhet të dërgohen në formë elektronike përmes SRrR.

Fondi Plotësues Pensional duhet të paraqesë në BQK kopjen e deklaratës së parimeve të investimeve dhe direktivat Investuese brenda 30 ditësh prej datës së miratimit, ndryshimit apo përshtatjes së tij. Fondi Plotësues Pensional do të dorëzojë në BQK deklaratën e menaxhimit të rrezikut të miratuar për të menaxhuar sigurinë e mjeteve pensionale.

Pjesë përbërëse e Rregullorës është edhe Shtojca 1 që është Fleta e Parë dhe Shkresa Përcjellëse e cila duhet të dorëzohet në formë fizike në BQK dhe e cila duhet të jetë e vulosur dhe nënshkruar nga drejtori menaxhues dhe personi përgjegjës që merret me plotësimin e raporteve.

IX. Rregullore MMPH Nr. 03/2016 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi

Më 4 Nëntor, 2016, Ushtruesi i Detyrës i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nënshkroi Rregullorën MMPH Nr. 03/2016 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi.

Qëllimi i kësaj Rregullore është përcaktimi i normave minimale teknike për projektimin e ndërtesave të banimit në bashkëpronësi si dhe hapësirat në funksion të tyre. Dispozitat e kësaj rregullore do të vlejnjë për ndërtesat e reja të banimit, rindërtimin dhe riparimin e ndërtesave ekzistuese të banimit në bashkëpronësi.

Sipas kësaj Rregullore, një njësi e banimit përfshinë, por nuk kufizohet në,:

- a. Hapësirat për banim siç janë dhoma e ditës apo dhoma për shumë qëllime, dhoma, tryezaria dhe kuzhina;

- b. Hapësirat siç janë depotë, garderoabat etj.;
- c. Hapësirat e komunikimit;
- d. Hapësirat e jashtme;

Kjo rregullore rregullon çështjet që lidhen, por nuk kufizohen, në:

- a. Hyrja në njësinë e banimit;
- b. Orientimi dhe pozicionimi i njësive të banimit;
- c. Ndriçimi natyror i banesës;
- d. Ajrosja e njësisë së banimit;
- e. Llojet e banesave;
- f. Lidhja ndërmjet hapësirave të banesës;
- g. Dimensionet minimale të hapësirave të banesës;
- h. Lartësia e pastër e katit;
- i. Normat minimale të sipërfaqeve të hapësirave të banesës;
- j. Llogaritja e sipërfaqes neto të hapësirave;

Ndërtimi i ndërtesave të banimit duhet të mundësoj fleksibilitet në përshtatjen e funksioneve të ndryshme. Ndërtimi dhe elementet tjera të ndërtesës duhet të projektohen nga materialet e përshtatshme të testuara në aspektin:

- a. Arkitekturik;
- b. Konstruktiv;
- c. Termo-izolues;
- d. Hidro-izolues;

Kjo rregullore lejon vendosjen e mbishkrimeve dhe reklamave të llojeve, madhësive dhe formave të ndryshme në fasadën, kulmin dhe sipërfaqet tjera të ndërtesës siç përcaktohet me dokumente të planifikimit hapësinor dhe rregulloreve të veçanta komunale.

Përmes dispozitave të ndryshme, kjo rregullore rregullon çështjet e mbrojtjes nga ndikimet atmosferike dhe ujërat nëntokësore, zhurma dhe zjarri duke e theksuar gjithashtu rëndësinë e ruajtjes së energjisë dhe rëndësinë e mirëmbajtjes së privatësisë dhe sigurisë.

Specifikat e instalimit të ujit, kanalizimit, rrymës elektrike, ngrohjes, ajrosjes dhe ftohjes janë gjithashtu të specifikuara në këtë rregullore.

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi shtatë ditë pas nënshkrimit të saj nga Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kjo rregullore do të shfuqizoj Rregulloren Nr. 04/2014 për Normat Minimale Teknike për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi si dhe për Hapësirat në Funksionin e Tyre.

X. Rregullore për Mbajtësin e Mjeteve të Pensioneve

Më 31 Tetor, 2016, Bordi i Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës ka miratuar Rregullore për Mbajtësin e Mjeteve të Pensioneve.

Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktohen kushtet dhe udhëzimet për veprimtarinë e Mbajtësit të Mjeteve të Pensioneve. Do të vlenë për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, Fondet Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit, dhe Pensionet Plotësuese Individuale.

Mbajtësit e Mjeteve të Pensioneve, të cilët licensohen nga Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës apo nga ndonjë shtet anëtar në Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, do të kryejnë aktivitetet e mbajtjes së mjeteve të pensioneve. Këto veprimtari do të kryhen në përputhje me Ligjin për Fondet Pensionale dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.

Fondi Pensional duhet të emërojë një mbajtës të vetëm, të cilit do ti delegoj obligimin e mbajtjes së mjeteve pensionale dhe lidh marrëveshje për mbajtjen e atyre mjeteve pensionale. Mbajtësi dhe nënpunësit e tij, të cilët kanë e veprimtari sa i përket fondit pensional, sipas kësaj rregullore janë të besuarit e Fondit.

Fondi Pensional duhet të njoftoj Bankën Qëndrore të Republikës së Kosovës (BQK) për emërtimin e Mbajtësit të Mjeteve të Pensioneve.

Mbajtësi i Mjeteve të Pensioneve, i cili është subjekt juridik në Kosovë, do të duhet të plotësoj këto kushte:

- a. Duhet të jetë i licensuar nga BQK-ja;
- b. Të ketë kapital minimal të paguar siç parashihet me rregulloret e BQK-së;
- c. Të mos veprojë si menaxhues i Fondit Pensional dhe të mos jetë person i ndërlidhur i drejtorit të mjeteve ose anëtar i këshillit drejtues të Fondit;
- d. Të mos i jep para hua drejtorit apo anëtarëve të tij dhe të mos marrë para hua prej drejtorit të mjeteve apo anëtarëve të tij;
- e. Të jetë i licensuar nga BQK-ja sipas rregulloreve bankare dhe të jetë i autorizuar për zhvillimin e biznesit bankar duke përfshirë mbajtjen e mjeteve pensionale;

Mbajtësi i mjeteve të pensioneve i cili është subjekt juridik jashtë Kosovës duhet të jetë i licensuar nga një rregullator i shërbimeve bankare, financiare ose i tregjeve të kapitalit të

një shteti anëtar i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. Ky i fundit, përpos tjerash, duhet ti ofroj dëshmi Fondit Pensional dhe BQK-së për licensimin e tij.

Detyrat e Mbajtësit të Mjeteve të Pensioneve përfshijnë, por nuk kufizohen, në:

- a. Të mbajë evidenën e garancioneve të çfarëdo forme të Fondit Pensional;
- b. Të regjistroj llogaritë korresponduese në regjistrin e fondit pensional që janë deponuar te Mbajtësi;
- c. T'i siguroj të gjithë informacionin e nevojshëm Fondit për t'i ndihmuar në përmbushjen e obligimeve ligjore;
- d. Të siguroj që menaxhuesi i mjeteve përmbush obligimet e tij ligjore në investimin e mjeteve të pensioneve;
- e. Të përgadisë dhe raportoj, raportet e rregullta të kërkuara sipas kërkesave rregullative të BQK-së;

Asnjë Mbajtës i Mjeteve të Pensioneve nuk mund të marrë në mbajtje mjetet e pensioneve, nëse nuk ekziston marrëveshja për mbajtjen e mjeteve të pensioneve me fondin e pensioneve

Kjo Rregullore ka hyrë në fuqi më 15 Nëntor, 2016 dhe shfuqizon Rregullin 8 për Mbajtësin e Mjeteve të Pensioneve.

XI. Rregullore Nr. 04/2016 Për Kërkesat Minimale për Sigurimin e Shenjave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë,

Më 25 nëntor Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale publikoi Rregulloren Nr. 04/2016 Për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë. Rregullorja do të hyjë në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit.

Baza ligjore e kësaj rregullore është Ligji Nr. 04/L-161 për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe është në përputhshmëri me Direktivën e Këshillit 92/58 EEC të dates 24 qershor 1992.

Kjo rregullore vlenë për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që hyjnë në kuadër të fushëveprimit të Ligjit Nr. 04/L-161 për shëndetin dhe sigurinë në punë, pavarësisht nga forma e organizimit, pronësia apo arsyet në bazë të të cilave kryhet puna. Megjithatë, kjo rregullore nuk vlenë për shenjat për plasimin në treg të substancave, përzirjeve, produkteve apo

paisjeve të rrezikshme, as për shenjat që përdoren në rregullimin e komunikacionit rrugor, hekurudhor, ujqor të brendshëm, detar apo ajror.

Kjo rregullore përmban nëntë (9) shtojca që rregullojnë kërkesa specifike në lidhje me shenjat për siguri dhe shëndet në punë.

XII. Rregullore Nr. 02/2016 Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit për Përdorimin e Pajisjeve Personale Mbrojtëse në Vendin e Punës

Më 25 nëntor Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale publikoi Rregulloren Nr. 02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës. Rregullorja do të hyjë në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit.

Baza ligjore e kësaj rregullore është Ligji Nr. 04/L-161 për shëndetin dhe sigurinë në punë. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës, të nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punësuarit në punë.

Kjo Rregullore vlenë për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që hyjnë në kuadër të fushëveprimit të Ligjit Nr. 04/L-161 për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Kjo Rregullore përmban 3 Shtojca, si mëposhtë:

- Listë jo shteruese e llojeve të pajisjeve personale mbrojtëse,
- Listë udhëzuese jo shteruese e veprimtarive dhe sektorëve të veprimtarisë që mund të kërkojnë sigurimin e pajisjeve personale mbrojtëse,
- Model dokumenti i vlerësimi të riskut për përgatitjen e listës së pajisjeve personale mbrojtëse sipar profesioneve.

XIII. Rregullore Nr. 03/2016 Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit për Mbrojtjen e Punësuarve Lidhur me Punën e Krahut me Ngarkesa

Më 25 nëntor Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale publikoi Rregulloren Nr. 03/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e punësuarve lidhur me punën e krahut me ngarkesa. Rregullorja do të hyjë në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit.

Baza ligjore e kësaj rregullore është Ligji Nr. 04/L-161 për shendetin dhe sigurinë në punë.

Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e të punësuarve lidhur me punën e krahut me ngarkesa kur ka risk për shëndetin, veçanarisht për dëmtime muskulo-skeletore, dhe është në përputhshmëri me Direktivën e Këshillit 90/269 KEE të datës 29 maj 1990.

Kjo rregullore vlenë për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që hyjnë në kuadër të fushëveprimit të Ligjit Nr. 04/L-161 për shendetin dhe sigurinë në punë.

Punëdhënësi duhet të marr masat e duhura organizative dhe përdorë mjetet e përshtatshme, në veçanti pajisjet mekanike, për të shmangur nevojën për punën e krahur me ngarkesa nga ana e të punësuarit.

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore janë dhe dy shtojca në lidhje me:

- Faktorët referencë për punën e krahut me ngarkesa, dhe
- Vlera kufi për punëm e krahut me ngarkesa.

Kontaktet e Deloitte:

Afrore Rudi

Drejtoreshë | Shërbime të Taksave dhe Ligjore
Deloitte Kosova sh.p.k.
Rr. Ali Hadri n.n., 10000
Prishtinë, Republika e Kosovës
Cel: +386 (0)49 590 807
E-mail: arudi@deloittece.com

Luljeta Plakolli - Kasumi

Menaxhere | Shërbime Ligjore
Deloitte Kosova sh.p.k.
Rr. Ali Hadri n.n., 10000
Prishtinë, Republika e Kosovës
Cel: +386 (0)49 780 769
E-mail: lplakollikasumi@deloittece.com

Përjashtim i përgjegjësisë:

Ky publikim përmban vetëm informacion të përgjithshëm dhe asnjëra nga firmat anëtare apo filialet e Deloitte Deloitte Touché Tohmatsu Limited (së bashku referohen si "Deloitte Network") përmes këtij publikimi ofrojnë këshilla apo shërbime profesionale për kontabilitet, biznes, financiare, investime, ligjore, tatimore apo këshilla dhe shërbime tjera profesionale.

Ky publikim nuk është zëvendësim i shërbimit apo këshillës profesionale, dhe nuk duhet të përdorur për të marr ndonjë vendim që mund të i ndikonte financat e biznesit tuaj. Para se të merrni ndonjë vendim apo veprim që do të mund të ndikonte në financat e biznesit tuaj, ju duhet të konsultoheni me një këshilltar profesional dhe të kualifikuar. Asnjë entitet i rrjetit të Deloitte nuk do të konsiderohet përgjegjës për ndonjë humbje të pësuar duke u bazuar në këtë publikim.

Deloitte i referohet një ose më shumë firmave të Deloitte Touché Tohmatsu Limited, një kompani private britanike e kufizuar nga garancitë dhe firmave të saj anëtare. Secila nga këto firma përfaqëson një entitet ligjor të ndare dhe të pavarur. Përshkrimin e detajuar të strukturës ligjore të organizatës Deloitte Touché Tohmatsu Limited dhe firmave të saj anëtare e gjeni në adresën www.deloitte.al/about.

Deloitte ofron shërbime në fushat e auditimit, taksës, konsulencë dhe konsulencë financiare klientëve si privat dhe publik në të gjitha industritë që ata operojnë. Në sajë të një rrjeti të lidhur ndërkombëtar të firmave anëtare në më shumë se 150 vende, Deloitte sjell mundësi të klasit të parë botëror dhe shërbime me kualitet të lartë për klientët, duke dhënë njohuritë tek ata që i adresojnë sfidat më komplekse. Pothuajse 244,400 profesionistë angazhohen që Deloitte të jetë etaloni i përsosmërisë.